



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR

Nr. 8256 / Prot  
144

Shkodër, më 17.8 .2021

MARRËVESHJE KUADËR

PËR SHËRBIME ME OBJEKT: TË MBËSHITESIM NOTIN NË SHKODËR

Kjo marreveshje lidhet sot, më datë \_\_\_ / \_\_\_ /2021 ndërmjet:

**BASHKISË SHKODËR** me adresë Rr. "13 Dhjetori", Nr 1, Shkodër, përfaqësuar nga Znj. Voltana ADEMI, në cilësinë e titullarit të Institucionit, në vijim referuar edhe si "**Bashkia**"

dhe

**SHOQATA SPORTIVE "SHKODRA NOT"**, me seli në Lagja Ndoc Mazi, rruga "Edith Durham", Shkodër, përfaqësuar nga z. Kol Shiroka me nr. NIPT-i M16724131P, në cilësinë e kryetarit të shoqatës, në vijim referuar edhe si "**Ekipi i Notit Villaznia**".

Bashkia dhe Subjekti fitues do të referohen në vijim edhe si "Pala" ose "Palët".

Duke qënë se Palët:

*Marrin në konsideratë* politikat zhvillimore të Bashkisë Shkodër në drejtim të organizimit të aktiviteteve që synojnë organizimin dhe mbështetjen e aktiviteteve sportive, që favorizojnë rritjen e zhvillimin e jetës sportive në territorin e Bashkisë Shkodër.

*Synojnë* realizimin e objektivave zhvillimore të Bashkisë Shkodër, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.

*Njohin* eksperiencën e Shoqatës Sportive " SHKODRA NOT ", në organizimin e aktiviteteve të sportive në Shqipëri.


*Konfirmojnë* angazhimin institucional për të bashkëpunuar në vijim të projektit "**TE MBESHITESIM NOTIN NE SHKODER**".

**Neni 1**

**Baza Ligjore**

- 1.1 Kodi Civil ligji nr.7850, datë 29.07.1994, i ndryshuar;
- 1.2 Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;
- 1.3 Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar;

Adresa: Rr. "13 Dhjetori", Nr.1 Shkodër, t.e.b. [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al), Tel: +35522400150



- 1.4 Ligji nr. 79/2017 “Për Sportin” i ndryshuar;
- 1.5 VKM nr.354, dt 29.8.1994 "Për shpërblimin e cilësisë të veprimtarive sportive, për sportistët, trajnerët e gjyqtarët dhe shpërblime të tjera sportive”, i ndryshuar
- 1.6 VKM nr 687 date 14.11.2018 “Për kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv, për mënyrën e shpërblimit të sportistëve që i arrijnë këto nivele, si dhe për përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive", të ndryshuar.
- 1.7 VKB nr. 69, datë 30.10.2017 për “Miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër” si dhe miratimin e metodologjisë LOD për financimin e organizatave të shoqërisë civile”;
- 1.8 VKB nr. 63 datë 28.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2021-2023 të Bashkisë Shkodër”;
- 1.9 VKB nr. 18 datë 25.03.2021 “Për vazhdimin e financimit të disiplinave sportive sipas PBA 2021-2023, programi ‘Sport dhe Argëtim’, përmes metodologjisë LOD, pas mbylljes së funksionimit të klubit sportiv ‘Vllaznia’ ”.
- 1.10 Urdhër nr. 671, datë 13.07.2021 “Për zbatimin e projekteve të shpallura fituese në thirrjen publike për organizatat e shoqërisë civile, sipas udhëzuesit për zbatimin e projekteve në kuadër të metodologjisë LOD, Programi Reload.

Palët së bashku bien dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje si më poshtë vijon:

## **Neni 2**

### **Qëllimi i Marrëveshjes**

Kjo kontratë ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve institucionale midis Bashkisë Shkodër dhe Shoqatës Sportive "Shkodra Not", për zbatimin e projektit “**Te Mbeshtesim Notin Ne Shkoder**” të gjithë ekipeve zinxhir me synimin e zhvillimit të sportit të notit në Bashkinë e Shkodrës dhe të marrë pjesë në kampionate kombëtare dhe ndërkombëtare në të gjitha disiplinat sportive të notit dhe të shpallë Kampionë Kombëtar.

## **Neni 3**

### **Objekti i Kontratës**

1. Përfaqësimi sa më dinjitoz dhe rezultate të larta në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare të notit.
2. Krijimi i kushteve optimale për zhvillimin e stervitjes së ekipit të notit të rritur të të gjitha grupmoshave me synim rritjen e cilësisë sportive dhe masivizimin.

## **Neni 4**

### **Afati i Marrëveshjes**

4.1 Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër është 24 (njetekatër) muaj.

